



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2025

Lënda: Kthim përgjigje .

Në përgjigje të shkresës Suaj, të datës 13.11.2025, administruar në bashkinë Shkodër me nr.23519.prot hyrës, datë 13.11.2025 me lëndë: “*Kërkesë për informacion*”, bazuar në ligjin nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar; ligjin nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar, Ju informojmë si vijon :

Në qendër të qytetit do të ndërtohet objekt 1,2,30, 34 dhe 35 kat, me leje ndërtimi nr. 283/14 prot, datë 08.09.2025 dhënë nga Këshilli Kombëtar i Territorit dhe Ujit, me subjekt ndërtues "Rozafa"A, Sh.p.k, punimet janë në fazën e hapjes së gropës së podrumit, informacion ky i administruar nga ana jonë me nepërmjet shkresës me lëndë: *Njoftim për fillim punimesh* .

Ndërmjet bashkisë Shkodër dhe Myftinisë Shkodër për këtë truall, nuk ka proces gjyqësor në shqyrtim. Ndërsa sa i takon statusit juridik të pronës, organ kompetent për dhëniën e këtij informacioni është Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Trualli objekti i kërkimit tuaj, nuk është pjesë e inventarit të pronave në pronësi të bashkisë Shkodër.

Sa i takon heqjes së tabelave, Policia Bashkiake ka ndërhyrë me heqjen e tabelës së vendosur në trotuar, jashtë perimetrit të oborrit të xhamisë "Ebu Beker", sipas procedurës së njëjtë të ndjekur në aksionin e përditshëm për lirimin e hapësirave publike në të gjithë territorin e Bashkisë Shkodër, bazuar në urdherin nr.851 date 15.07.2025 "Për ngritjen e grupit të punës për verifikimin e gjendjes dhe lirimin e hapësirave publike në territorin Administrativ të Bashkisë Shkodër.

Sa i përket menaxhimit të trafikut, ju informojmë se punimet po kryhen brenda rrethimit të pronës private dhe nuk janë konstatuar ankesa në lidhje me qarkullimin rrugor. Megjithatë, situata dhe zona në fjalë mbahen nën monitorim nga ana e Policisë Bashkiake.

Në lidhje me planin urbanistik dhe zhvillimor të bashkisë Shkodër, ky plan është miratuar me Vendimin nr.5, datë 16.10.20217 të KKT, rishikuar me vendimin nr.9, datë 28.12.2020 te KKT dhe rezulton i publikuar për akses nga publiku në linkun: <https://planifikimi.gov.al/index.php?id=732> bashkia Shkoder.

Ndërsa sa i takon kërkesave për kopjen e projektit, vlerën e investimit, konsultimin publik etj. ju informojmë që për çdo informacion mbi procesin e lejes së ndërtimit, duhet ti drejtoheni AKZHT - KKTU në cilësinë e strukturës përgjegjëse sipas ligjit për dhënien e kësaj leje ndërtimi, ku dhe administrohet dokumentacioni i përkatës.

Duke Ju falenderuar,

KRYETAR

Benet BECI

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETAR

Alban PREKA